



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Dëgjimi i përgjithshëm publik mbajtur më 24.7.2026, i cili filloi në orën 14:00

Të pranishëm ishin: Drejtori i shëndetësisë - Bujar Gashi, drejtoresha e Financave - Valbona Makolli, nga drejtoria e Administratës - Driton Bardheci, Drejtoresha e Bujqësisë - Jeta Rafuna, Drejtori i Shërbimeve Publike - Leutrim Retkoceri, Drejtor i Mobilitetit - Pëllumb Bajqinovci, Drejtor i Sportit - Granit Geci, Drejtor i Arsimit - Arianit Elshani, Drejtoresha e Parqeve - Albana Gjonbalaj, Shef i Sektorit të Investimeve Kapitale - Liridon Shahini, Drejtoria e Turizmit - Rrezarta Aliu, Drejtori i Rinisë - Donat Gashi.

Osman Bllaca: - hap dëgjimin e pestë dhe të fundit buxhetor për këtë cikël të planifikimit të buxhetit për vitin 2027, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit, qytetarëve dhe përfaqësuesve të grupeve të ndryshme.

Feim Osman: - asambleist nga partia e Lëvizjes Vetëvendosje, zotri Osmani, kërkoj rritje të investimeve kapitale për zonat rurale të Prishtinës, duke propozuar që mbi 10 % e buxhetit të përgjithshëm të dedikohet për projektet në fshatra. Gjithashtu u kërkuar zhvillim i barabartë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, përfshirja në buxhet e kërkesave të qytetarëve dhe këshillave lokale që tashmë janë dorëzuar, si dhe reflektimi real i dëgjimeve buxhetore në buxhetin për vitin 2027.

Donjeta Dragusha: - asambleiste nga partia e Lidhjes Demokratike e Kosovës, gjatë diskutimit është kërkuar përfundimi i rrugës “Mallakastra” dhe zgjatja e kolektorit përtej rrugës “Qazim Dragusha” në drejtim të Barilevës. U kërkuar ndërtimi i një shkolle të re fillore në Besi dhe një çerdhe që do t’u shërbente fshatrave Besi, Prugovc, Barilevë dhe Drenoc. Për fshatin Vranidoll u

kërkua rregullimi i kanalizimit dhe asfaltimi i rrugës kryesore. Gjithashtu, u kërkua asfaltimi i rrugicave në Besi dhe Prugovc, ndërtimi i trotuarit, vendosja e pengesave për uljen e shpejtësisë pranë shkollës “**Nexhmi Mustafa**”, zgjatja e linjës së autobusit S28 deri në Prugovc, vendosja e numrave të shtëpive dhe emërtimi i rrugëve, si dhe funksionalizimi i objektit të bashkësisë lokale në Prugovc.

Gëzim Sveçla: - asambleist nga partia e Lëvizjes Vetëvendosje, u kërkua që në buxhetin 2027 të mos përfshihen projekte me probleme ligjore apo në procese gjyqësore, në mënyrë që mjetet buxhetore të mos mbeten të bllokuara. Po ashtu, u kërkua që të paktën 10 % e buxhetit të dedikohet për investime në zonat rurale. Si prioritete kryesore u theksuan rritja e investimeve për menaxhimin e mbeturinave, përmirësimi i trafikut urban dhe lehtësimi i komunikacionit. Gjithashtu, u kërkua që buxheti të sigurojë zhvillim të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale, duke marrë parasysh edhe parimet e buxhetimit gjinor.

Fiknete Bejta: - asambleiste nga partia e Lidhjes Demokratike e Kosovës, kërkoj që në buxhetin 2027 të bëhet përfshirja e projekteve për asfaltimin, zhavorimin dhe trajtimin e një sërë rrugësh në Prapashticë, Ballaban, Glllogovicë, Dabishec, Marec, Keçekollë, Veternik, Bernicë të Epërme dhe Mramor, me theks të veçantë në zgjerimin e rrugës “Arif Batolli” për rritjen e sigurisë në trafik. Gjithashtu, u kërkua ndriçimi publik në Veternik, Kolovicë dhe Bernicë të Epërme, si dhe sanimi i gropave në rrugët “Feris Guri” dhe “Kasëm Haxhim Murati”. U theksua që këto projekte të trajtohen me prioritet dhe të përfshihen në planifikimin e investimeve për vitin 2027, pasi janë kërkesa të vazhdueshme të qytetarëve.

Lindita Rexhepi: - nga asambleistja e Lidhjes Demokratike e Kosovës, kërkoj nga Drejtoria e Investimeve Kapitale të jetë me prioritet në buxhetin 2027 rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen Ulpiana, për shkak të gjendjes së amortizuar dhe rrezikut për shëndetin e banorëve. Gjithashtu, u kërkua zëvendësimi i kulmeve me azbest, renovimi i këndit të lojërave për fëmijë në Ulpianë dhe furnizimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare nr. 5 në Dardani me printerë për çdo ordinancë, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe uljes së pritjeve të pacientëve.

Enver: - paraqiti dy kërkesa nga banorët, kërkesa e parë që e paraqiti lidhet me rrugën që lidh fshatin Marec me Krilevën, përkatësisht lagjen Bullaj të Marecit, e cila lidh Prishtinën me Kamenicën dhe mundëson lidhjen edhe me Artanën përmes Prekovcit. Ai theksoi rëndësinë e saj gjeografike dhe historike, duke përmendur se gjatë luftës në lagjen Bullaj gjetën strehim shumë banorë të Prishtinës dhe se kjo zonë u frekuentua nga shumë ushtarë të UÇK-së dhe dëshmorë të kombit. Meqë projekti është i kompletuar prej më shumë se 10 vitesh, Enveri kërkoi që Drejtoria

e Investimeve Kapitale të ndërmarrë hapa konkretë për realizimin e tij dhe t'a përfshijë në buxhetin e vitit 2027, në bashkëpunim të mundshëm edhe me Komunën e Kamenicës dhe Ministrinë e Infrastrukturës. Ndërsa kërkesa e dytë lidhet me bustin e Faik Rexhepit pranë ëmbëltores Korzo, në sheshin "Zahir Pajaziti". Enveri kërkoi që pranë bustit të vendoset një pllakë informuese me një përshkrim të shkurtër për Faik Rexhepin dhe aktin e tij të rezistencës paqësore më 29 gusht 1990. Ai vlerësoi se kjo ndërhyrje ka kosto të ulët, por rëndësi të madhe për ruajtjen e kujtesës historike, edukimin e brezave të rinj dhe informimin e vizitorëve, duke kërkuar që edhe kjo të përfshihet në buxhetin e vitit 2027.

Bajram Sopi – banor nga Butovci: - përgëzoj për iniciativën e parashikimit të buxhetit për vitin 2027, dhe ju uroj sukses në punën e mëtejshme. Kërkesa ime lidhet me përfundimin e rrugës "Azem Sopi" në Butovc, projekt i cili ka filluar para tetë viteve dhe ka mbetur pa përfunduar. Rreth 600-700 metra janë asfaltuar, ndërsa rreth 2000 metra kanë mbetur të gatshme për asfaltim. Gjendja e kësaj rruge është përkeqësuar dhe po vështirëson qarkullimin e banorëve dhe transportin e produkteve bujqësore. Kërkoj që kjo rrugë, si arterie kryesore e fshatit, të përfshihet në buxhet dhe të përfundojë sa më shpejt. Deri në asfaltim, të bëhet intervenimi i nevojshëm me zhavorr dhe rregullimi i pjesëve të dëmtuara. Kërkesa është dorëzuar edhe më herët dhe shpresoj të merret parasysh. Faleminderit.

Bedri Hajzeri: - kryetar i Bashkësisë lokale Koliq: - përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se kërkesat e Bashkësisë lokale Koliq janë paraqitur edhe në takimet e mëparshme me kryetarin dhe drejtorët. Ai u ndal te disa projekte prioritare që kanë mbetur përgjysmë, kryesisht në infrastrukturën rrugore. Kërkoi vazhdimin e punimeve në rrugën e lagjes Kapiti, e cila tashmë ka filluar, si dhe realizimin e projektit Keçekoll - Koliq i cili është i gatshëm për vazhdim. Gjithashtu kërkoi vazhdimin e rrugës në lagjen Peraj dhe rrugës "Voli" deri në Kallçak. Një kërkesë tjetër ishte hartimi i një projekti për rrugët e shkurtra lidhëse me rrugën kryesore, për të zgjidhur problemet e shumë familjeve. Ai theksoi se këto kërkesa janë prioritare për banorët dhe janë përgatitur edhe me shkrim për t'u dorëzuar. Në fund falënderoi komunën dhe asamblistin Shefqet për kontributin dhe përkrahjen ndaj fshatit Koliq.

Isa Rexha- kryetar i Këshillit lokal Barilevë- Drenoc: - kryetar i Bashkësisë lokale Barilevë - Drenoc, paraqiti shqetësimet dhe kërkesat e banorëve, duke theksuar se ato janë dorëzuar zyrtarisht në komunë me dokumentacion përkatës. Ai shprehu pakënaqësi për mosrealizimin e projekteve të planifikuara, si ura në lagjen Leci, dhe ngriti shqetësime për gjendjen e saj të pasigurt. Rexha kërkoi përmirësimin e infrastrukturës, përfshirë rrugët, kanalizimin, ndriçimin publik dhe vendosjen e ulëseve në hapësirat që frekuentohen nga qytetarët. Gjithashtu, ai theksoi problemin e kanalizimit pranë varrezave të Drenocit, duke e cilësuar si prioritet urgjent për shkak të vështirësive që krijojnë gjatë ceremonive mortore. Në fund, ai u bëri thirrje institucioneve që të mos ndryshojnë projektet e planifikuara në buxhet dhe të realizojnë investimet e premtuara në dobi të banorëve.

Misim Krasniqi, banor i fshatit Drenoc: shprehu shqetësimin për planifikimin e ndërtimit të një thertoreje pranë varrezave, shtëpive dhe shkollës, duke kërkuar që ky projekt të rishqyrtohet. Ai theksoi se banorët kundërshtojnë vendosjen e saj në atë lokacion për shkak të ndikimit negativ në jetën e përditshme. Gjithashtu, ngriti si problem urgjent gjendjen e varrezave, të cilat që nga viti 2016 përmythen vazhdimisht nga uji, duke vështirësuar ceremonitë e varrimit. Sipas tij, familjarët detyrohen të presin tharjen e tokës ose të kryejnë varrimet në kushte të papërshtatshme. Ai kërkoi nga institucionet që t'i trajtojnë me prioritet këto çështje, duke ofruar edhe fotografi dhe video si dëshmi të situatës.

Avdi Aliu- kryesues i Këshillit lokal të Keçekollës: - përshëndeti të pranishmit dhe paraqiti kërkesat e banorëve të Prapashticës, Keçekollës, Ballabanit dhe Nishecit. Ai bëri të ditur se kërkesat i ka dorëzuar edhe me shkrim dhe kërkoi që ato të përfshihen në buxhetin e vitit 2027. Sipas tij, këto fshatra kanë ende nevojë për investime në infrastrukturën rrugore, pasi një pjesë e rrugëve vazhdojnë të jenë me zhavorr. Gjithashtu, kërkoi përmirësimin e ndriçimit publik në zonat më të banuara. Një ndër shqetësimet kryesore ishte mungesa e ujit të pijshëm, problem që ishte theksuar sidomos gjatë vitit të kaluar. Ai propozoi që komuna të shqyrtojë mundësinë e funksionalizimit të një burimi ekzistues në Keçekollë, ku rezervuarët dhe infrastruktura janë të ndërtuara që nga koha e ish-Jugosllavisë. Sipas tij, kjo mund të ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme për furnizimin me ujë. Aliu ngriti edhe çështjen e kanalizimeve, duke theksuar nevojën për të parandaluar derdhjen e ujërave të zeza në lumin që derdhet në Liqenin e Batllavës. Ai sugjeroi ndërtimin e kanalizimeve ose, aty ku kjo nuk është e realizueshme, përdorimin e gropave septike. Në fund, ai falënderoi komunën për bashkëpunimin dhe shprehu mirënjohje të veçantë për asambleistin dhe afaristin Shefqet Osmani për kontributin e tij në avancimin e projekteve për zhvillimin e kësaj zone.

Rizaj Ilazi- qytetar nga fshati Ballaban: - ngriti shqetësimin për gjendjen e rëndë të infrastrukturës rrugore në këtë fshat. Ai theksoi se problemi i rrugës “Ibrahim Beta” është i njohur për të gjithë kryetarët e Komunës së Prishtinës ndër vite, por ende nuk është zgjidhur. Sipas tij, nga projekti i nisur në vitin 2023 është asfaltuar vetëm 1 km, ndërsa rreth 1.5 km, të rrugës kryesore kanë mbetur të papërfunduara. Ai tha se gjatë vjeshtës dhe dimrit rruga bëhet e pakalueshme, duke vështirësuar jetën e banorëve dhe furnizimin me gjërat bazë. Ilazi theksoi se si pasojë e kushteve të vështira, numri i familjeve në fshat është zvogëluar dhe shumë banorë janë shpërngulur. Ai deklaroi se janë bërë mbi 20 kërkesa dhe ankesa drejtuar komunës, por nuk kanë marrë përgjigje apo qasje te drejtuesit komunalë. Sipas tij, mungesa e investimeve ka ndikuar në zbrazjen e Gollakut, mbylljen e shkollave dhe ambulancave. Në fund, ai kërkoi nga drejtorët komunalë që kërkesa e banorëve të Ballabanit t'i përcillet drejtpërdrejt kryetarit të komunës dhe të ndërmerren masa urgjente për përfundimin e rrugës kryesore.

Nikol Farsworth – qytetare: - në fjalën e saj, qytetarja nga lagjja Sofali paraqiti disa kërkesa për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe infrastrukturës në Prishtinë. Ajo theksoi mungesën e punëtorëve socialë në Qendrat për Punë Sociale, duke sqaruar se secili prej tyre trajton mbi 55 raste, ndërsa standardet parashohin, jo më shumë se 20 raste për punëtor. Propozimi ishte që komuna të angazhojë katër punëtorë socialë shtesë, me një kosto prej rreth 36.000 € në vit, për të përmirësuar trajtimin e rasteve të dhunës në baza gjinore dhe mirëqenien e grave, fëmijëve dhe grupeve të tjera në nevojë. Po ashtu, ajo kërkoi krijimin e një fondi emergjent për viktimat e dhunës, i cili do të mbulonte shpenzime të domosdoshme si medikamente, qumësht për fëmijë dhe veshmbathje për gratë që largohen nga shtëpia pa mjete. Në fund, ngriti edhe një shqetësim personal lidhur me mosndërtimin e një rruge në lagjen Sofali, e cila prej gjashtë vitesh ka mbetur e papërfunduar, duke penguar banorët të jetojnë në shtëpitë e tyre. Ajo kërkoi përshejtimin e këtij projekti dhe publikimin e shtojcës për barazi gjinore në buxhet, në mënyrë që qytetarët të kenë më shumë transparencë për mënyrën se si shpenzohen fondet publike.

Deli Avdiu - kryetar i lagjes Çagllavica 2 dhe në Vetërnik: -folësi paraqiti kërkesat e qytetarëve për vitin 2026, duke theksuar se shumica e tyre janë përsëritur vazhdimisht që nga viti 2015, madje edhe më herët, pa u realizuar. Ai nënvizoi nevojën për ndërtimin e dy shkollave të reja në zonën që përfaqëson, për shkak të rritjes së popullsisë dhe mungesës së kapaciteteve arsimore. Sipas tij, njëra shkollë ka nisur ndërtimin para disa vitesh, ndërsa tjetra vitin e kaluar, por asnjëra nuk është përfunduar. Një tjetër shqetësim ishte mungesa e një zyre funksionale për bashkësinë lokale, e cila prej shumë vitesh vazhdon të mbetet pa hapësirë dhe pa mjete pune. Ai theksoi se që nga viti 2012 nuk është ndarë asnjë buxhet për funksionimin e saj dhe se shpenzimet i ka mbuluar vetë për t'u përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Folësi u bëri thirrje asamblistëve të rinj që të punojnë për interesin e të gjithë qytetarëve, pa dallime politike, duke mbështetur çdo propozim që sjell përfitim për komunitetin. Ai theksoi se shërbimet publike, si shkollat dhe infrastruktura, duhet të jenë në dispozicion të të gjithëve. Në fund, ai tregoi se kishte siguruar mbështetje nga KFOR-i italian për pajisjen e zyrës së bashkësisë lokale, por projekti nuk u realizua për shkak të premtimeve të pambajtura nga drejtoria përkatëse. Ai shprehu zhgënjimin për mungesën e veprimeve konkrete dhe kërkoi që institucionet komunale të përmbushin premtimet dhe të zgjidhin problemet e kahershme të qytetarëve.

Shaip Haziri – qytetar: - folësi paraqiti shqetësimet e banorëve të lagjes Veselaj në fshatin Koliq, duke theksuar se kjo zonë ka mbetur e pazhvilluar edhe pas shumë vitesh. Ai tha se, megjithëse ka vendosur të rikthehet për të jetuar dhe investuar në vendlindje, mungesa e infrastrukturës e bën jetën shumë të vështirë. Problemi kryesor është rruga prej rreth 1.5 kilometrash, e cila është në gjendje të rëndë dhe gjatë stinës me reshje, mund të kalohet vetëm me traktor ose automjete të përshtatshme. Sipas tij, familja ka investuar në përmirësimin e rrugës, ndërsa ndërhyrjet e komunës kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk kanë sjellë zgjidhje afatgjatë. Për shkak të gjendjes së rrugës, ai nuk ka mundur të transportojë prodhimet nga pemishtja prej pesë hektarësh, duke pësuar humbje të konsiderueshme. Në fund, ai kërkoi nga Komuna e Prishtinës të dërgojë një komision për të

vlerësuar gjendjen në terren dhe të vendosë prioritete të qarta për investimet, në mënyrë që banorët të kenë kushte normale jetese dhe zhvillimi.

Sahit Hasani - prej Koliqi qytetar: - folësi ngriti shqetësimin për mungesën e investimeve në lagjen, mahalla e podit të fshatit Koliq, duke theksuar se tri rrugë të rëndësishme vazhdojnë të mbeten të pashtuara. Ai tha se banorëve u ishte premtuar nga përfaqësues komunalë se rrugët do të rregulloheshin, por premtimet nuk janë realizuar. Sipas tij, materiali i paraparë për shtrimin e rrugëve është përdorur në zona të tjera, ndërsa lagjja e tyre është lënë pas dore. Ai shtoi se për këtë çështje ka dorëzuar dokumentacion edhe në institucionet përgjegjëse, përfshirë organet kundër korrupsionit. Folësi theksoi se në fshat nuk ka pasur investime komunale për rreth pesë vjet, ndërsa disa familje jetojnë aty përgjithmonë dhe të tjera janë në proces ndërtimi. Ai kërkoi që komuna t'a trajtojë me prioritet shtrimin e rrugëve, duke paralajmëruar se nëse nuk merren masa, banorët do t'i drejtohen rrugëve ligjore për të kërkuar zgjidhje. Ai përfundoi duke kërkuar trajtim të barabartë për lagjen e tyre dhe realizimin e premtimeve të dhëna.

Faik Shaqiri - banor i lagjes Mati 1 (Muharrem Fejza): - paraqiti kërkesat kryesore të banorëve të kësaj zone. Ai theksoi se banorët janë ndër tatimpaguesit më të mëdhenj të Prishtinës dhe kërkojnë investime më të mëdha nga komuna. Kërkesat përfshijnë ndërtimin e një çerdheje publike, hapjen e një zyre për bashkësinë lokale, krijimin e një qendre për të moshuar dhe një qendre kulturore për të rinjtë. Gjithashtu, ai kërkoi sigurimin e objekteve për nënstacionin e policisë dhe të zjarrfikësve, përmirësimin e ndriçimit publik në të gjitha rrugët e lagjes, ndërtimin e një fushe sportive funksionale dhe organizimin e mësimit gjithëditor në shkollën "Pavarësia". Në përfundim, ai theksoi se këto kërkesa janë ngritur edhe më herët nga përfaqësues të tjerë të lagjes dhe kërkoi që ato të trajtohen me prioritet.

Ismet Tahiri, - fshati Koliq: - tha se ne kemi plot kërkesa, por që kjo është ndër të parat që as nuk po mundemi me punuar se kemi problem, për shembull së pari tokën e punojmë. Unë e kam punuar vetë tokën, më është dashtë 100 € me i dhënë për kombaj për shkak s'ka ardhur me hy aty dhe me korrë. Ai shtoi para pes - gjashtë muaj kemi pasur dy vdekje. As s'kemi mundur të shkojm me traktor, duhet me shkuar qysh të mundemi se është rruga e keqe. Ne më shumë nuk kemi kërkesë këtu, dhe ne fund u falenderua.

Ekrem Ademi - nga fshati Keçekollë: - aktualisht jeton përkohësisht në Koliq. Arsyeja e zhvendosjes është se rruga që çon te trashëgimia ime familjare nga babai dhe babagjyshi nuk ka qenë e rregulluar deri vitin e kaluar. Për këtë arsye, më është dhënë një parcelë prej 10 ari nga daja në Koliq, ku kam ndërtuar shtëpinë. Bëhet fjalë për rreth 300 metra rrugë afër varrezave dhe vilave Lisi. Kjo rrugë është e vështirë për t'u kaluar, sidomos gjatë dimrit dhe verës. Unë dhe

familja ime kemi investuar në pemishte, bahçe dhe ambiente të tjera që kërkojnë mirëmbajtje. Ai theksio se për shkak të gjendjes së rrugës, shpesh është e pamundur të shfrytëzohen këto investime. Edhe pse problemet e të tjerëve mund të duken më të mëdha, shpresoj që edhe kërkesa ime të merret parasysh. Gjathashtu ai tha se rruga nuk ka emër të veçantë, por ndodhet afër kthesës ku përfundon asfalti për në Keçekollë. Ajo lidhet edhe me rrugën që shkon drejt Hajdarevit. Ai tha se kërkesa ime nuk është për shumë punime, por vetëm për rregullimin me zhavorr rreth 300 metrave rrugë. Kjo do të mundësonte qarkullim më të lehtë gjatë periudhave të vështira të vitit. Rruga do të shërbente për katër familje që jetojnë dhe kanë investuar në atë zonë. Ne fund tha se shpresoj që institucionet përgjegjëse t'a shqyrtojnë këtë kërkesë dhe të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit.

Bejtullah Abdullahu – Banor i lagjes Bregu i Diellit:- propozoi ndërtimin e një parku memorial për të shënuar 30-vjetorin e demonstratave të 1 Tetorit 1997, si kujtesë institucionale për ngjarjet historike. Sugjeroi që memoriali të përfshijë pllaka përkujtimore, elemente informuese dhe përmbajtje digjitale (si QR kode) për edukimin e brezave të rinj. Propozoi që projekti të lidhet me një muze të Universitetit të Prishtinës, në bashkëpunim me universitetin dhe institucionet përkatëse. Kërkoi që oborret e shkollave dhe institucioneve publike të shfrytëzohen më shumë për gjelbërim dhe mbjelljen e drunjtë, për të shtuar hapësirat e gjelbra në qytet.

Shefqet Osmani – asamblist : - theksoi se fshati Koliq ka mbetur i pa trajtuar për më shumë se 10-15 vjet dhe kërkoi që të jetë prioritet në buxhetin e vitit 2027. Kërkoi ndërtimin e rrugës së lagjes Tahiraj, e cila lidh Koliqin me Keçekollën dhe shkurton qarkullimin me rreth 16 km. Theksoi se rruga është në gjendje shumë të rëndë, duke vështirësuar qarkullimin e banorëve, mjeteve bujqësore dhe shërbimeve emergjente. Kërkoi që të shmanget investimi i vazhdueshëm në zhavor dhe të realizohen rrugë të asfaltuara e të përfunduara. Tha se investimet duhet të përqendrohen në projektet prioritare dhe të përfundojnë sipas planifikimit buxhetor. Falënderoi komunën për fillimin e ndërtimit të Qendrës së mjekësisë familjare në Koliq dhe realizimin e disa rrugëve. Kërkoi renovimin e shkollës “Tefik Çanga” në Koliq dhe ndërtimin e një salle të edukatës fizike. Kërkoi realizimin e dy parqeve publike pranë shkollës “Zenel Hajdini” në Kodrën e Trimave, duke theksuar se lagja nuk ka asnjë park. Theksoi se parcelat janë pronë publike dhe kërkoi që komuna të ndërmarrë veprime për t'i zhvilluar ato si hapësira rekreative. Kërkoi zgjatjen e orarit të punës në QKMF-në e Kodrës së Trimave, së paku deri në orën 24:00, për shkak të rritjes së numrit të banorëve dhe kërkesës për shërbime shëndetësore. Paralajmëroi se nuk do ta mbështesë buxhetin nëse projektet prioritare për Koliqin dhe zonën e Gollakut nuk përfshihen në planifikimin buxhetor.

Bujar Gashi - drejtor i Shëndetësisë: - sqaroi se sistemi i printerëve është pjesë e sistemit BasicHIS, i menaxhuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe nuk është në kompetencë të komunës. Tha se të gjitha dokumentet printohen në sportel, gjë që krijon vonesa dhe detyron pacientët të kthehen te mjeku për vulosje. Theksoi se komuna ka kërkuar implementimin e nënshkrimit digjital, i cili do ta lehtësonte procesin dhe do të shmangte kthimin e pacientëve te mjeku. Sqaroi se nuk ka nevojë për printerë shtesë, pasi sistemi aktual është funksional dhe i centralizuar.

Lindita Rexhepi – asambleiste: - falënderoi drejtorin për përgjigjen dhe korrektësinë.

Tha se përshkrimi i procesit të vizitës mjekësore ishte i saktë dhe përputhet me përvojën e pacientëve. Theksoi se kërkesa kryesore është të largohen pritjet dhe pengesat gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore. Shprehu pritjen që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.

Bujar Gashi - drejtor i Shëndetësisë: - konfirmoi se QKMF-ja në Kodrën e Trimave është e mbingarkuar dhe se aktualisht kujdestaria 24-orëshe ofrohet vetëm në tri qendra: QKMF, QMF Xhemajl Ibish dhe QMF Ulpianë-Dardani. Theksoi se me numrin aktual të stafit është e pamundur të zgjatet orari apo të hapen qendra të reja 24-orëshe. Sqaroi se pritjet miratimi i Statutit unik nga Ministria e Shëndetësisë, i cili do të përcaktojë edhe organizimin e orarit të punës. U zotua se, pasi statuti të vijë në Kuvend, do të kërkojë që Prishtina të ketë trajtim të veçantë dhe më shumë qendra me orar të zgjatur, duke u bazuar edhe në kërkesat e qytetarëve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2027,
24.7.2026

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Bedri Hazrov	Hazrov	KR. I B.L		
2	Shafiq	Osmani	assembleist		
3	Avdi	Aliu	KL. Kogedh		
4	Ali	Aliu	Gjytarov		
5	BAJRAM	JOPI	Fjsh. BUTOV		
6	Shqip	AZIZI	fsh. KOLIQ		
7	SHENSI	ISMAILI	FSH KOLIQ		
8	FAK	SHAGIM	MANA/JOV		
9	EMR	DEM	SHKURTIAK		
10	Faim	OSMANI	Asambleist		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Enver	Rea	Asamblest		
12	MISIM	KASNICI	Qytetar		
13	FAHRIJE	BERISHA	Qytetar		
14	ISQ	Rea	Qytetar		
15	DURIM	BERISHA	Qytetar		
16	ENDRIT	ZABERGJA	ASAMBLIST		
17	GËZIM	SVECLA	ASAMBLIST		
18	RAMË	SALIH	QYTETAR		
19	Riza	TICAJ	QYTETAR		
20	Salih	Rea	QYTETAR		
21	SALIH	REXHOPI	QYTETAR		
22	BEJTULLAH	ABDULLAHU	QYTETAR		
23	GENTRIT	TAHIRI	QYTETAR		
24	AVDULL	Tahiri	QYTETAR		
25	HAFIZ	TAHIRI	QYTETAR		
26	DAGIP	TAHIRI	QYTETAR		
27	ENVER	TAHIRI	QYTETAR		
28	Salih	Taluni	QYTETAR		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------

29	ADEM	TAHIR	QYTETAR		
30	Deli	Ardui	K.K.L. Çagllavica		
31	FIKRETE	BEJTA	ASAMBLEISTE		
32	Nicole	Farnsworth	Qytetar		
33	LINDITA	REXHEPI OSMANI	ASAMBLEISTE		
34	Bonjeta	Dragusha	Asambleisto		
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen! *